



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 03, datë 03.09.2019

PËR
MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:
“RIKONSTRUKSION I QENDRËS SHËNDETËSORE “ZOGAJ”, ME VENDNDODHJE
NË BASHKINË SHKODËR”

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të Bashkisë Shkodër, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin: “Rikonstruksion i Qendrës Shëndetësore “Zogaj”, me vendndodhje në Bashkinë Shkodër, me zhvillues Bashkinë Shkodër.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

OGERTA MANASTIRLIU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

